

Të nderuar konsumatorë,

Prej 1 janar të vitit 2010 me vendim të Komisionit Rregullator për Energjetikë, çmimi i energjisë elektrike deri te konsumatorët e fundit u rrit për 9,98 %.

Kjo do të thotë se faturat e muajit janar janë të llogaritura sipas çmimit të ri të energjisë elektrike.

Çmimi i energjisë elektrike të cilën e paguajnë konsumatorët tanë, në fakt paraqet shumën e çmimeve për prodhim (ELEM), përçim (MEPSO), distribuim dhe furnizim (EVN Macedonia) të energjisë elektrike.

- **Në çmimin e energjisë elektrike për konsumatorët e fundit, ELEM merr pjesë me 55,75%.**

Në pajtim me Ligjin për Energjetikë, ELEM si prodhues i rregullt i energjisë elektrike është i obliguar të sigurojë sasi të mjaftueshme të energjisë elektrike (nga prodhimi personal dhe nga importi) për nevojat e konsumatorëve tariforë (të fundit).

- **Në çmimin e energjisë elektrike për konsumatorët e fundit, MEPSO merr pjesë me 6.51%.**

MEPSO është sistem operator dhe operator përçues dhe ka për obligim që ta përçojë tërë energjinë elektrike të prodhuar nëpërmjet sistemit për përçim nga prodhuesit e kyçur në rrjetin përçues dhe nga sistemet përçuese fqinje deri te sistemi i distribuimit dhe konsumatorët e kyçur drejtpërdrejt në rrjetin përçues.


- **Në çmimin e energjisë elektrike për konsumatorët e fundit, EVN Macedonia merr pjesë me 37.74%.**

EVN Macedonia është distribues dhe furnizues i konsumatorëve tarifues me sasi të vogël (konsumatorët e fundit). Për këtë qëllim EVN Macedonia furnizohet me energji elektrike nga ELEM-i dhe merr me qira kapacitet përçues nga MEPSO që ta përçojë energjinë elektrike deri te shtëpitë e konsumatorëve.

Ashtu që, edhe pse EVN Macedonia ua paguan shumën e tërësishme konsumatorëve të vetë për energjinë e konsumuar elektrike, merr vetëm 37.74 % nga shuma e fakturuar, ndërsa shuma tjetër shkon te dy kompanitë tjera pjesëmarrëse në treg – ELEM dhe MEPSO.

Çmimet dhe tarifat për energji elektrike i cakton Komisioni Rregullator për energjetikë.

Formimi i çmimit për konsumatorët e fundit



info@evn.com.mk

për informata: 0890 12345
për defekte: 0890 88888

EVN
macedonia 